

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gjykata fajësoi Thaçin, por dokumenti i vitit 2000 sfidon versionin e Hagës për Behajdin Allaqin: Gruaja e tij tha se e mori policia serbe
ADRESA	https://piranjat.al/kosova/gjykata-fajesoi-thacin-por-dokumenti-i-vitit-2000-sfidon-versionin-e-hage-i104647
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 13:01:07 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 12:55:09 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	761f7d8ffdadf8597c90e146deb995b3d9252a7fae4d2e0efb22267ec10200be
TEKSTI	4106603952e40873da8e4c5997eef0f35e79fbd337d1d099bc0e9240cafb06e4
PAMJA	05457cafaa6119e04bca8d4975bd4eb819477e3e99c1da2c0bdf19e6112570d5

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	af66e4388d781eb5db70018d35ab138082237ccd1bfe1bddf04f97abb57a69be
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c459fbdf88f453b54a4131a2c6b72ae8533f09b2deef09d60e250bd91e1b553d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/af66e4388d781eb5db70018d35ab138082237ccd1bfe1bddf04f97abb57a69be

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: **versionin e Hagës për** të vëmendjes rastin e ■ **dhe financat** sanksioneve dhe t... ■ **forta së bashku** mbajtur hapjen në gjuhën ■ **nyrje-daljet e** Enea Karaka&c... **protestat: MARRE!** prot...

KOSOVA

Gjykata fajësoi Thaçin, por dokumenti i vitit 2000 sfidon versionin e Hagës për Behajdin Allaqi: Gruaja e tij tha se e mori policia serbe

Piranjat Përditësimi i fundit 17 Shtator 2026, 14:55



Një dokument hetimor i vitit 2000 po rikthen në qendër të vëmendjes rastin e zhdukjes së Behajdin Allaqi, një prej rasteve që Gjykata Speciale përdori në arsyetimin e aktgjyqimit të 16 shtatorit ndaj ish-drejtuësve të UÇK-së.

Dokumenti përmban një element të rëndësishëm që duhet ballafaquar me arsyetimin e Gjykatës: bashkëshortja e Behajdin Allaqi, Nazmije Allaqi, kishte deklaruar tek autoritetet se burrin e saj e kishte marrë policia serbe.

Sipas raportit hetimor, më 21 nëntor 2000, ose rreth kësaj date, Nazmije Allaqi raportoi se bashkëshorti i saj ishte i zhdukur që prej 11 qershorit 1998. Rasti u regjistrua me numrin 2001-000512.

Në pjesën "Background of Case", dokumenti shënon se Nazmije Allaqi kishte raportuar se bashkëshorti i saj ishte marrë nga policia serbe në fshatin Drenoc dhe se prej asaj kohe ajo nuk e kishte parë dhe nuk kishte dëgjuar më prej tij.

Ky version bie ndesh me përfundimin që Trupi Gjyqësor i Dhomave të Specializuara bëri publik më 16 shtator 2026. Sipas përmbledhjes së aktgjyqimit të shpallur nga gjyqtari Charles Smith, Gjykata arriti në përfundimin se Hashim Thaçi ishte përfshirë personalisht në arrestimin, ndalimin, transferimin dhe vrasjen e paligjshme të Behajdin Allaqi.

Në arsyetimin e lexuar në sallë, Gjykata e lidhi rastin edhe me një konflikt të mëhershëm. Sipas Trupit Gjyqësor, në vitin 1993 Allaqi kishte pasur një mosmarrëveshje serioze me Hashim Thaçin dhe Azem Sylën lidhur me Shaban Shalën, i cili dyshohej prej tyre si spiun i Serbisë.

Gjykata tha gjithashtu se, para zhdukjes, Behajdin Allaqi ishte nën vëzhgimin e shërbimit të zbulimit të UÇK-së dhe se Thaçi e Kadri Veseli kishin kërkuar të informoheshin për praninë e tij në shtabin e UÇK-së në Drenoc.

images (1).jpeg

Sipas versionit të pranuar nga Trupi Gjyqësor, më 11 qershor 1998 ose rreth kësaj date, Allaqi u largua nga shtëpia dhe shkoi në shtabin e UÇK-së në Drenoc. Gjykata konstatoi se Thaçi dhe Veseli mbërritën më pas dhe e morën Allaqin në pranga. Ai nuk u pa më dhe Trupi Gjyqësor tha se ishte bindur se Allaqi ishte vrarë.

Gjykata interpretoi edhe Komunikatën nr. 61 të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, të 1 nëntorit 1998, ku thuhej se Behajdin Allaqi kishte rënë dëshmor në betejë. Sipas Trupit Gjyqësor, kjo komunikatë ishte përdorur si mbulesë për të fshehur atë që kishte ndodhur me të.

Por dokumenti i vitit 2000 sjell një version tjetër nga personi më i afërt i Allaqi. Dy vjet pas zhdukjes, bashkëshortja e tij u kishte thënë autoriteteve se ai ishte marrë nga policia serbe në Drenoc.

Ky dokument nuk provon, i vetëm, se cili prej dy versioneve është i saktë. Ai ngre megjithatë pyetje të drejtpërdrejta për arsyetimin e aktgjyqimit: A ishte ky raport pjesë e provave të administruara në proces? A e shqyrtoi Gjykata deklarinë e Nazmije Allaqi? Nëse po, pse nuk e konsideroi të besueshëm ose vendimtar? Dhe cilat prova e bindën Trupin Gjyqësor përtej këtij versioni të dhënë nga bashkëshortja?

Përgjigjja përfundimtare kërkon shqyrtimin e aktgjyqimit të plotë dhe referencave të tij provuese, jo vetëm përmbledhjen e lexuar në sallë. Procesi ishte jashtëzakonisht voluminoz: Gjykata thotë se kishte para saj prova nga rreth 270 dëshmitarë, 5,467 prova materiale dhe rreth 29 mijë faqe transkripte.

Pikërisht këtu dokumenti mund të marrë rëndësi edhe në betejën e ardhshme juridike. Mbrojtja mund të shqyrtojë nëse deklarimi i bashkëshortes është administruar dhe si është peshuar kundrejt provave mbi të cilat Gjykata ndërtoi përfundimin e saj për fatin e Behajdin Allaqit. Dhoma e Specializuar shpallën më 16 shtator aktgjykimin e shkallës së parë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Procesi kishte nisur më 3 prill 2023 dhe faza e provave ishte mbyllur në dhjetor 2025. Rasti Allaqi tashmë pritet të jetë një nga çështjet që do të analizohen me kujdes nga ekipet e mbrojtjes: nga njëra anë përfundimi i Gjykatës së Allaqi u mor dhe u vra nga pjesëtarët të UÇK-së, dhe nga ana tjetër dokumenti ku bashkëshortja e tij kishte raportuar se burrin ia kishte marrë policia serbe. ...“Gjithashtu, z. Thaçi mori pjesë dhe inkurajoi kryerjen e krimeve në mënyra të ndryshme që përfshinin si vijon. Përmes publikimit të komunikatave dhe deklaratave politike dhe përdorimit të “luftës speciale”, z. Thaçi shprehu tolerancë dhe inkurajim për kryerjen e krimeve kundër kundërshtarëve. Z. Thaçi gjithashtu mori pjesë personalisht në krime, përfshirë në arrestimin, ndalimin dhe marrjen në pyetje të 13 parlamentarëve në Qirez dhe Baicë, në arrestimin, ndalimin, transferimin dhe vrasjen e paligjshme të Behajdin Allaqit, dhe kishte dijeni për arrestimin dhe ndalimin e disa personave të tjerë. Në lidhje me Behajdin Allaqin, Trupi Gjykoes konstatoi se në vitin 1993, Behajdin Allaqi kishte pasur një mosmarrëveshje serioze me Hashim Thaçin dhe Azem Sylën, të cilët e akuzuan se kishte sjellë një spiun të pretenduar të Serbisë, Shaban Shalën, në radhët e lëvizjes politike të cilës i takonin, me çka i kishte vënë në rrezik të madh anëtarët e lëvizjes. Kjo rezultoi në marrjen prej z. Thaçi të rolit që i ishte premtuar Behajdin Allaqit. Trupi Gjykoes gjithashtu ka konstatuar se para zhdukjes së tij, Behajdin Allaqi kishte qenë nën vëzhgimin e shërbimit të zbulimit të UÇK-së. Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli kishin kërkuar të informoheshin për praninë e tij në shtabin e UÇK-së në Drenoc. Më 11 qershor 1998, ose rreth kësaj date, Behajdin Allaqi u nis prej shtëpisë së vet dhe shkoi në shtabin e UÇK-së në Drenoc. Pak më pas, mbërritën z. Thaçi dhe Kadri Veseli. Ata e morën Behajdin Allaqin në pranga. Behajdin Allaqi nuk u pa më kurrë dhe Trupi Gjykoes është bindur se ai u vra. Për të fshehur përgjegjësinë, personat në fjalë ndërmorën masa të ndryshme. Më 1 nëntor 1998, u publikua Komunikata 61 nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së ku thuhet se Behajdin Allaqi kishte rënë dëshmor në betejë. Kjo ishte mbulesë që kishte për qëllim të fshihte të vërtetën për atë që i kishte ndodhur Behajdin Allaqi. Po kështu, pas luftës, Hashim Thaçi, Kadri Veseli dhe Azem Sylja u përpoqën të qetësonin familjen e Behajdin Allaqit me ryshfet dhe premtime në mënyrë që të hiqte dorë nga kërkimi i drejtësisë dhe i së vërtetës. Është meritë e jashtëzakonshme e familjes që u rezistoi këtyre ofertave. Edhe Shaban Shala ishte 24 arrestuar dhe keqtrajtuar nga UÇK-ja në Drenoc. Edhe ai u vra në rrethanat e përshkuara në Aktgjykim”, tha gjyqtari Charles Smith	
Artikuj te sugjeruar	
KOSOVA 17 Shtator14:31 <u>Haga dënoi me 81 vite burg ish-krerët e UÇK-së/ Studentët në Prishtinë nisin protestat: MARRE!</u> Dhjetëra studentë janë grumbulluar në sheshin “Skënderbeu” në Prishtinë ditën e sotme, ndërsa po prot...	
KOSOVA 17 Shtator10:07 <u>“Me kokën lart babë, gjithmonë!”/ Djali i Jakup Krasniqit me mesazh një ditë pas vendimit</u> Pas aktgjykimit ndaj ish-kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, djali i tij, Altin Krasniqi, ka reaguar përmes një mesazhi...	
KOSOVA 17 Shtator09:07 <u>Kreu i Odës Ndërkombëtare të Avokatëve: Aktgjykimi mund të sfidohet si në fakte, ashtu edhe në ligj</u> Aktgjykimi ndaj katër ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës pritet të përballlet me një proces t&eu...	
KOSOVA 16 Shtator23:01 <u>Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së/ Zv.kryeministri shqiptar i Malit të Zi: Vendim i padrejtë, procesi nuk ka përfunduar</u> Zv.kryeministri shqiptar i Malit të Zi, Nik Gjelosha, ka reaguar pas aktgjykimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hag&eu...	
KOSOVA 16 Shtator22:57 <u>Dënimi i Hashim Thaçit/ Le Monde: Gjykata Speciale kontroverse, përdori edhe prova nga Beogradi</u> Ish-presidenti i Kosovës Hashim Thaçi, është dënuar me 25 vite burgim nga Dhoma e Specializuar në Hagë për krime luf...	
KOSOVA 16 Shtator22:44 <u>Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, Bardhi ndan foton e të riut: Mos u mërzit, vëllai i vogël! Asnjë vendim nuk e ndryshon historinë e luftës çlirimtare</u> Kreu i grupit parlamentar të PD-së, Gazment Bardhi, ka reaguar sërish për dënimin e katër ish-krerëve të U&Cce...	
KOSOVA 16 Shtator22:42 <u>Vuçiq ‘studion’ reagimet e zyrtarëve të lartë të rajonit pas vendimit në Hagë, ndalet te Begaj e Rama, ‘kërcënon’ Malin e Zi</u> Pas vendimit të dhënë nga Gjykata Speciale e Kosovës në Hagë, ku ish-liderët e UÇK u dënuan me 81 vite burgim p&e...	
KOSOVA 16 Shtator22:36 <u>Vendimi i Hagës, Martens: UÇK-ja nuk lindi nga asgjëja, nuk duhet të humbasim gjykimin historik</u> Gazetari i njohur i Frankfurter Allgemeine Zeitung, Michael Martens, ka komentuar vendimin e Gjykatës Speciale në Hagë ndaj ish-drejtuësve të...	
KOSOVA 16 Shtator22:25 <u>“Pse Vuçiq nuk është thirrur në Hagë?” Walker: I mërzitur e zhgënjyer nga BE, vendosi shenjë e barazimit me tmerret serbe</u> Një moment të keq për Kosovën, të gjithë Ballkanin dhe Europën e ka konsideruar ish-shefi i misionit të OSBE-së n&e...	
KOSOVA 16 Shtator22:10	

[Djali i Hashim Thaçit reagon pas dënimit të të atit me 25 vjet burg: Kjo betejë nuk ka mbaruar](#)

Endrit Thaçi, djali i ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, ka reagu pas vendimit të Dhomave të Specializuara të Ko...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 16 Shtator

[Sarandë, tre persona plagosen me thikë pranë sh...](#)

Një ngjarje e rëndë është shënuar mbrëmjen e sotme në Sarandë, ku tre persona kanë mbetur të plagosur me ...

BOTA 16 Shtator

[VIDEO- Dy aksidente me pesë viktime/ Prezantues...](#)

Pesë persona kanë humbur jetën në një aksident të dyfishtë tragjik në Los Anxhelos, ndërsa një gazetare televi...

KOSOVA 16 Shtator

[Kush është Charles Smith, gjyqtari që dënoi me...](#)

Charles L. Smith III është gjyqtari amerikan që kryesoi trupin gjykues në çështjen ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, R...

INVESTIGIME 31 Maj14:01

[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafigas, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...


video



E premte | ? 20:45 | Syri TV



E premte | ? 20:45 | Syri TV



Çdo të premte | ? 20:45 | Syri TV



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.